


## Festivali polip:


# KUJTDO QË I BËHET VONË! ÇKA PËR ÇËSHTJEN E AMBIENTIT?


14-16 maj, Prishtinë

## Shfaqje teatri: **ORDER OF THE DAY**

 Lokacioni: Burgu i Idealit, Prishtinë, Kosovë

 Data: E premte, 15 maj

 Ora: 20:00

 Na shkruani në [info@qendra.org](mailto:info@qendra.org) ose në +383 44 430 693 për të rezervuar vendin tuaj!

**Gjuha:** anglisht dhe shqip

**Hyrja e lirë**

### **Përshkrimi i shfaqjes:**

*Order of the Day* është një shfaqje teatri ngushtësisht e lidhur me ngjarjet aktuale, e krijuar brenda një dite të vetme. Në një kohë kur lajmet na vijnë si një ortek i mbingarkuar informacioni, kjo shfaqje filtron thelbësoren dhe e paraqet në një mënyrë të vetën, të veçantë dhe teatrale. Tekstet dhe muzika shkruhen në moment—ndonjëherë edhe gjatë vetë performancës—dhe interpretohen me skenar në dorë; kjo është thelbi i kësaj aventure teatrore. Brenda një dite, ngjarjet aktuale deshifrohen, shpërbëhendhe analizohen, dhe po atë ditë krijohet edhe shfaqja. Këngët, skeçet dhe skenat interpretohen vetëm një herë, duke e bërë këtë një përvojë unike dhe të papërsëritshme.

Skeçe të mprehta, këngë therëse, vëzhgime të ndjeshme dhe dialogë poetikë, të gjitha të ndërthurura bashkë. Një përmbledhje përpjekjesh për të vendosur rend në lajmet e ditës—me një rrëshqitje të garantuar drejt kaosit të plotë, por gjithmonë e shoqëruar nga magjia e momentit. Vëzhgimet e krijuesve janë baza, por reagimet e publikut janë “qershia mbi tortë”.

Pjesëmarrësit: Jibbe Willems (dramaturg) / Greg Nottrot (drejtor artistik) / Vera Morina (dramaturge) / Vanja Rukavina (shkrimtare dhe aktore) / Frank van Kasteren (kompozitor dhe producent) / Mark Kraan (aktor) / Jeton Neziraj (dramaturg) / Adrian Morina (aktor) / Shpëtim Selmani (aktor) / May-Linda Kosumovic (aktore) / Veronica Botelho (shkrimtare)



**polip**  
FESTIVAL

15 maj, 20:00

# ORDER OF THE DAY

Prodhuar nga

**Het NUT & Qendra Multimedia**



Vendi i ngjarjes:  
Muzeu i Burgut të Prishtinës,  
Burgu i Idealit

Het nut

qendra  
multimedia